






Cilët janë treguesit kryesor të tranzicionit të energjisë elektrike në Kosovë?




Për të vlerësuar tranzicionin e energjisë në Kosovë, kemi përdorur një metodologji që analizon raportin midis burimeve të ripërtitshme të energjisë (BRE) dhe prodhimit të energjisë elektrike nga linjiti. Ky buletin fokusohet në kapacitetin aktual të integruar të BRE-ve, si dhe në planifikimin afatmesëm dhe afatgjatë deri në vitin 2050. Synimi është të ofrojë një pasqyrë të qartë të përpjekjeve për tranzicion dhe të kontribuojë në ndërtimin e një të ardhmeje të qëndrueshme për energjinë elektrike në Kosovë.

Raporti aktual ndërmjet BRE-ve dhe termocentraleve nga linjiti

Pavarësisht investimeve të fundit në burimet e ripërtitshme të energjisë (BRE), veçanërisht në centralet me erë, kapaciteti total instalues i tyre mbetet në disproporcion në krahasim me kapacitetet ekzistuese prodhuese nga linjiti.


Niveli strategjik (objektivat) në zhvillimin e BRE-ve në Kosovë


Kosova, si nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, ka marrë angazhime për dekarbonizimin e sektorit të energjisë elektrike, duke vendosur objektiva për rritjen e përdorimit të energjisë së ripërtitshme. Strategjia e Kosovës për Energji 2022-2031, e miratuar në vitin 2023, synon që deri në vitin 2031, 35% e konsumit të energjisë elektrike të mbulohet nga burimet e rinovueshme. Pjesëmarrja e këtyre burimeve aktualisht është rreth 9%, duke treguar një zhvendosje të rëndësishme nga prodhimi i energjisë me bazë linjiti drejt burimeve më të pastra dhe më të qëndrueshme.



Sipas Strategjisë së Energjisë së Kosovës për periudhën 2022-2031, është parashikuar ndërtimi i 1320 MW kapacitete të reja nga burimet e ripërtëritshme të energjisë (BRE). Këto kapacitete përfaqësojnë një hap të rëndësishëm drejt tranzicionit energjetik, me synimin për të reduktuar varësinë nga burimet fosile dhe për të adresuar detyrimet e Kosovës në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) ka kryer një analizë më të thellë për periudhën 2032-2050, me fokus në dekarbonizimin e plotë të sektorit të energjisë elektrike deri në vitin 2050. Duke marrë parasysh mungesën e parashikimeve zyrtare për periudhën pas vitit 2031, INDEP ka supozuar një rritje të moderuar të konsumit të energjisë me një normë mesatare prej 1% në vit nga viti 2024 deri në vitin 2050.

Bazuar në këtë supozim, analiza parashikon shtimin e kapaciteteve të reja të BRE për të plotësuar kërkesën në rritje për energji. Përveç kësaj, është paraparë mbyllja graduale e termocentraleve të vjetëruara me qymyr, duke ndihmuar në uljen e ndotjes së mjedisit dhe përmbushjen e objektivave të klimës. Ky tranzicion gradual është paraqitur në një grafik që ilustron kohëzgjatjen e mbylljes së termocentraleve dhe shtimin e kapaciteteve të BRE deri në vitin 2050, duke siguruar një sistem energjetik të qëndrueshëm dhe me ndikim të ulët karbonik për të ardhmen.







Gjatë dekadës së fundit, kapaciteti total i instaluar përmes skemave mbështetëse është 224 MW. Duke parë përpara, shtimin e 1320 MW të kapaciteteve të reja të energjisë së ripërtitshme nga viti 2024 në 2031 mund të konsiderohet tepër ambicioz. Për të arritur këtë synim kërkohet një angazhim i pashembullt nga të gjithë aktorët. Pa përpjekje kolektive dhe të paprecedentë, këto shifra mund të mbeten thjesht si parashikime strategjike, duke mos arritur të realizojmë progresin e parashikuar në zhvillimin e energjisë së ripërtitshme drejt dekarbonizimit të sektorit të energjisë elektrike.

Vlen të përmendet se sipas strategjisë do të instalohen së paku 170MW të kapacitetit për akumulimin e energjisë përmes baterive në sistemin e saj energjetik deri në vitin 2031, prej tyre 35 MW deri në vitin 2025. Gjithashtu është vendosur targeti prej 20MW prodhim të energjisë nga biomasa, por mbetet të shihet nëse ky target është real për faktin se ka interesim tepër të ulët për ndërtimin e kapaciteteve të reja me biomasë.

Për të ilustruar atë që u tha më lart për të arritur objektivi strategjik drejt dekarbonizimit të sektorit të energjisë elektrike do të duhej që deri në vitin 2025 të ndërtohen rreth 210 MW shtesë (së bashku solare dhe me kapacitete me erë) për t'u arritur caku prej 490MW total BRE (279.5 MW ekzistuese + 210MW të reja), ndërsa për periudhën 2026-2031, mesatarisht çdo vit duhet të instalohen rreth 165 MW për tu arritur caku final strategjik prej 1600MW kapacitete të instaluar të BRE-ve deri në vitin 2031.

Nga viti 2032 deri në vitin 2040 duhet të synohet që të komisionohen 735 MW kapacitete të reja të BRE-ve, ndërsa nga viti 2041 deri në vitin 2050 duhet të ndërtohen rreth 1000 MW kapacitete të reja kryesisht solare dhe me erë, kjo nën supozimin që kapacitetet e reja ndërtuara nga viti 2025 deri në vitin 2031 janë aktive. Me poshtë mund të shihet proporcioni e BRE-ve në raport me kapaciteteve me linjit deri në vitin 2031, ku shihet se në vitin 2030 kapacitetet instaluese të BRE-ve tejkalojnë ato me linjit.





Tema për buletin e radhës:

Si mund të kontribuojnë investimet në sektorin e ndërtesave për të nxitur tranzicionin e qëndrueshëm të energjisë përmes skemave të financimit të përshtatshme?

*Përmbajtja e këtij punimi është
përgjegjësi vetëm e Institutit për
Politika Zhvillimore (INDEP) dhe nuk
pasqyron domosdoshmërisht
pikëpamjet e Heinrich Böll Stiftung
(HBS).*